



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.05.2018.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 09.07.2018.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar””
5. Shqyrtimi i projektligjit “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.
6. Të tjera.

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Elisa Spiropali, Sadri Abazi, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamani, Klodiana Spahiu, Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj, Ilir Beqaj, Rudina Hajdari.

Mungojnë: Genc Pollo, Fatmir Velaj, Taulant Balla, Aldo Bumçi Vangjel Dule, Grida Shqina, Jorida Tabaku

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Alba Thoma – Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes

Gentiana Milkani – Drejtore e Inspektimit në AKSHE

Erjola Karagozi - Përgjegjëse e Sektorit të Legjislacionit dhe Përfaqësimit në AKSHE.

Albana Shkurta – Zëvendësministre në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Majlinda Hafizi –Drejtoreshë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
Mamica Dhamo- Specialiste në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
Ejana Xhixha – Kryeinspektore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
Julian Llupo - Drejtor i ISHMT-së
Valbona Jaupllari – Përfaqësuese e ISHMT-së
Artan Shkreli – Zëvendësministër i Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës
Krislen Keri - Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil
Arben Sula – Drejtor
Thimjo Plaku – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Transportit në Ministrinë e Energjisë
dhe Infrastrukturës
Lilika Radovicka - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi - Mirëdita!

Meqë kemi kuorum, fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Integrimin Europian.

Sot në rendin e ditës janë 6 çështje:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.05.2018.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 09.07.2018.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar””
5. Shqyrtimi i projektligjit “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.
6. Të tjera.

Fillojmë me miratimin e dy procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara. Jua kemi dërguar me *e-mail*.

Ka ndonjë vërejtje për procesverbalet e mbledhjes 14.05.2018? Nuk ka.

Kush është pro? Abstenim? Kundër? Nuk ka.

Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 14.05.2018.

Për procesverbalin e mbledhjes së datës 09.07.2018, kush është pro? Abstenim? Kundër? Nuk ka.

Miratohet edhe procesverbali i datës 09.07.2018.

Kalojmë në pikën 3, të shqyrtimi i projektligjit “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.

Të ftuar për këtë projektligj janë përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes.

Zoti Petro Koçi, zëvendësministër.

Mirëserdhe, zoti Koçi!

Zonja Alba Thoma, sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes; zonja Gentiana Milkani, drejtore e Inspektimit të AKSHE-së, si dhe zonja Erjola Karagjozi, përgjegjëse e Sektorit të Legjislacionit dhe Përfaqësimit në AKSHE.

Shkurtimisht, të dëgjojmë një paraqitje të projektligjit nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrotjtjes, nga propozuesit, nga Këshilli i Ministrave dhe pastaj të kalojmë në diskutime dhe pyetje sipas procedurës, nëse ka.

Kush do ta marrë fjalën?

Po, zoti Koçi, fjala për ju.

Petro Koçi – Faleminderit, zoti nënkryetar i komisionit dhe drejtues i mbledhjes!

Të nderuar deputetë,

Ligji “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” është shumë i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me çështje të sigurisë kombëtare dhe, natyrisht, është një veprimtari me sensibilitet të lartë.

Ky lloj ligji dhe kjo lloj veprimtarie vjen kryesisht për shkak të rregulimeve ndërkombëtare. Janë iniciativa të përbashkëta ndërkombëtare për të rregulluar transferimet e mallrave ushtarake dhe të atyre mallrave apo teknologjive me përdorim të dyfishtë, sepse në të kundërt do të kishte një kaos dhe ju e dini që pasojat do të ishin shumë të rënda.

Detyrat kombëtare, së pari, vijnë për shkak të detyrimeve që kemi ndaj rezolutës 1540 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së. Detyrimi tjetër vjen për shkak të procesit të integrimin europian, që lidhet me kriteret e domosdoshme që duhet të zbatojë Shqipëria në përmbajtje të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, e firmosur mes Shqipërisë dhe BE-së.

Lidhur me këtë, dua të theksoj se ka pasur një Rregullore të vjetër në fuqi të BE-së, nr. 13/34, që është e vitit 2000, e cila është shfuqizuar dhe ka një Rregullore të re, nr. 428, e datës 5 maj 2009. Ne jemi të detyruar që në procesin e përafrimit të legjislacionit tonë të ecim në përputhje me këtë Rregullore të re, sepse edhe ligji në fuqi nuk ka një përputhje të plotë me Rregulloren e vjetër. Ka pasur një përjasje apo një përafrim të pjesshëm.

Ligji në fuqi ka disa problematika, që janë vërejtur gjatë zbatimit të tij.

Së pari, nuk bëhet dallim i qartë mes licencave dhe autorizimeve.

Gjithashtu, në përmbajtje të ligjit nuk kishte dispozita të qarta. Ndryshe trajtonin transferimin e mallrave ushtarake dhe ndryshe transferimin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë. Ligji i ri i përcakton këto më qartë.

Duke e përmbyllur, dua të them se për ligjin kanë punuar ekspertët e DASH-it, të cilët janë pjesë e programit XBS, si dhe ekspertët e BE-së, nëpërmjet programit IU, *Be to Be, Export Control Program*. Të gjithë këta, në bashkëpunim me ekspertët tanë të AKSHE-së, që kur kanë analizuar

në fillim veprimtarinë e agjencisë, por edhe fushën në përgjithësi, konkluduan se duhej të bëhej patjetër një ligj i ri.

Besoje se kaq mjafton për ta paraqitur si projektligj.

Ju jeni komisioni përgjegjës. Në fakt, ne e kemi kaluar këtë projektligj në Komisionin e Sigurisë, edhe në parim, edhe nën për nen, por ata janë duke pritur vendimin tuaj, në mënyrë që të hyjë në fuqi shqyrtimi nën për nen që ata bënë sot në komision.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Koçi!

Në fakt, Komisioni i Integritetit është komision për dhënie mendimi për të tria projektligjet që po shqyrtojmë sot.

Sipas procedurës, kalojmë te pyetjet dhe pastaj me diskutimet nga kolegët, nëse do të ketë.

A ka ndonjë pyetje?

Po, zoti Tushaj.

Viktor Tushaj – Faleminderit, zoti drejtues i mbledhjes!

Unë do të doja ta falënderoja zotin zëvendësministër për ekspozenë e projektligjit!

Ai përmendi në sqarimin e tij se moskalimi i këtij ligji do të kishte pasoja të rënda dhe se ligji tjetër, ligji i deritanishëm, ka pasur ose ka krijuar disa ngërçe.

Do të doja të dija se çfarë pasojash të rënda ka pasur deri tani ky ligj në Ministrinë e Mbrojtjes, që i rregullon projektligji i ri?

Petro Koçi – Është një keqkuptim. Unë thashë që nëse nuk do të rregullohej kjo veprimtari, do të kishte pasoja shumë të rënda. Kur fola për pasoja të rënda, e kisha fjalën për hipotezën që nuk do të kishte rregull ndërkombëtar, nuk do të kishte iniciativa, pra do të ishte një veprimtari në kaos dhe ju e dini se çfarë do të ndodhte me organizatat, me individët terroristë, me shtetet dhe strukturat, që janë të interesuara për destabilitet dhe terrorizëm ndërkombëtar.

Lidhur me veprimtarinë e deritanishme të AKSHE-së dhe funksionimin e ligjit, ka pasur vetëm disa problematika, që unë i përmenda.

Ligji nuk ka përcaktim të qartë mes licencave dhe autorizimeve. Gjithashtu, ligji nuk ka përcaktim të qartë as për mallrat ushtarake, që janë të drejtpërdrejta, dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, që janë një gjë tjetër, por prapë është një fushë me sensibilitet të lartë, pasi mund të jenë mallra, të cilat vijnë për arsye industriale, por mund të përdoren edhe për arsye të tjera.

Prandaj, duhet që edhe kjo çështje të rregullohet. Pra, ligji aktual dhe funksionimi i deritanishëm në zbatim të ligjit i AKSHE-së, vetëm këtu ka problematikë.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit!

A ka pyetje tjetër apo diskutime? Nuk ka.

Sipas traditës procedurale që kemi në komision, shërbimet ndihmëse të komisionit kanë përgatitur një opinion, meqë jemi komision për dhënie mendimi, që është rakorduar me sugjerimet për komisionin përgjegjës, i cili është rakorduar me përfaqësues të ministrisë dhe të qeverisë.

Kështu që do të doja ta kalonim opinionin për votim, për t’ia përcjellë më pas komisionit përgjegjës për ta kaluar në shqyrtim nen për nen.

Kalojmë në votim opinionin për projektligjin “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjisë me përdorim të dyfishtë”.

Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Falënderojmë përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes për prezencën në komision!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.””

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Elisa Spiropali, Sadri Abazi, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamani, Klodiana Spahiu, Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj, Ilir Beqaj, Rudina Hajdari.

Mungojnë: Genc Pollo, Fatmir Velaj, Taulant Balla, Aldo Bumçi, Vangjel Dule, Grida Shqina (Duma), Jorida Tabaku

Të ftuar:

Albana Shkurta – Zëvendësministre në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Majlinda Hafizi – Drejtore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Mamica Dhamo- Specialiste në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Ejana Xhixha – Kryeinspektore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Julian Llupo - Drejtor i ISHMT-së

Valbona Jaupllari – Përfaqësuese e ISHMT-së

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi - Kalojmë në çështjen tjetër rendit të ditës, te shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar””.

Nga qeveria dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë të ftuar: zonja Albana Shkurta; zonja Majlinda Hafizi, drejtore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave; zonja Mamica Dhamo, specialiste në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave; zonja Ejana Xhixha, kryeinspektore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, zoti Julian Llupo, drejtor i ISHMT-së, si dhe zonja Valbona Jaupllari, përfaqësuese e ISHMT-së.

Nuk kanë ardhur?

Mos janë jashtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë.

Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit.

Fillimisht do të dëgjojmë një paraqitje të përmbledhur nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe pastaj do të kalojmë në pyetje dhe diskutime.

Majlinda Hafizi – Faleminderit!

Bledar Çuçi – Ju lutem, prezantohuni!

Majlinda Hafizi - Unë quhem Majlinda Hafizi, drejtore e Politikave të zhvillimit ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Desha të sqaroj që ekipi teknik, pra pjesa tjetër e përfaqësuesve nga inspektorati, është planifikuar, me kërkesën e tyre, të marrë pjesë te Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese. Është thjesht një keqkuptim.

Bledar Çuçi – Ju lutem, bëni një paraqitje të shkurtër për ligjin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, afroje pak mikrofonin!

Mamica Dhamo - Projektligji i propozuar “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008” synon të realizojë këto qëllime kryesore: harmonizimin me legjislacionin europian të fushës së mbrojtjes së konsumatorëve, konkretisht me dy direktivat, atë për të drejtat

e konsumatorëve, 2011/83, me të cilën shënohet përafrimi i plotë i kësaj direktive, si dhe direktivën për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve, 2013/11. Kjo synon përafrimin e pjesshëm.

Synimi i dytë është përcaktimi i rregullave më të mira për informimin e konsumatorëve, për cilësinë dhe shërbimet që ofrohen në treg, duke synuar vendosjen e ekuilibrave të drejtpërdrejtë, duke pasur parasysh që në marrëdhënien tipike tregtar-konsumator, tregtari konsiderohet si pala më e informuar dhe konsumatori si pala më pak e informuar. Pikërisht përcaktimi i këtyre rregullave synon të përmirësojë këtë...(nuk dëgjohej)

Synimi i tretë është që nëpërmjet këtij projektligji konsumatorëve t'u ofrohen zgjidhjen alternative për mosmarrëveshjet mes tyre dhe tregtarëve, nëpërmjet procedurave më të thjeshta, më transparente, të paanshme, duke respektuar kërkesat që parashikon direktiva 2013.

Skema që projektligji parashikon është që sektorët e shërbimit të interesit të përgjithshëm, kryesisht energjia, furnizimi me ujë, komunikimi elektronik dhe Aviacioni Civil, nëpërmjet ligjeve të tyre specifike, marrin në ngarkim të vendosin struktura të zgjidhjeve alternative. Nëpërmjet këtij ligji, ligjet e tyre specifike plotësohen duke përcaktuar procedurat dhe kriteret se si duhet të funksionojnë këto...(nuk kuptohej) Ndërkohë, për strukturat që mbeten të pambuluara parashikohet ngritja e një strukture të parashikuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu, projektligji parashikon dispozita në lidhje me shtrirjen e mbrojtjes së elementëve edhe në pushtetin vendor, duke i deleguar atij disa kompetenca në lidhje me informimin, ndërgjegjësimin dhe grumbullimin e ankesave.

Pak a shumë këto ishin ndryshimet në vija të përgjithshme.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

A ka pyetje apo diskutime? Nuk ka.

Edhe për këtë projektligj jemi komision për dhënie mendimi. Kemi hartuar një opinion, ku kemi bërë tri sugjerime në lidhje me ndryshimet, të cilat janë rakorduar me ministrinë përkatës. Kështu që, sipas procedurës dhe traditës së komisionit, do të na duhet të votojmë pikërisht dokumentin e hartuar nga shërbimet mbështetëse.

Meqenëse kemi kuorumin, kalojmë në miratimin e opinionit për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 1704.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, të ndryshuar””. Kemi bërë disa sugjerime për komisionin përgjegjës.

Kush është dakord me opinionin? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet opinioni për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 1704.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, të ndryshuar””.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.07.2018, ora 12:10

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Elisa Spiropali, Sadri Abazi, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamani, Klodiana Spahiu, Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj, Ilir Beqaj, Rudina Hajdari.

Mungojnë: Genc Pollo, Fatmir Velaj, Taulant Balla, Aldo Bumçi, Vangjel Dule, Grida Shqina, Jorida Tabaku

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Energjisë dhe Infrastrukturës

Krislen Keri – Drejtor i Përgjithshëm i AAC-së

Arben Sula – Drejtor në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Renata Teta – Përfaqësues e Sektorit të Politikave të Transportit Ajror

Bledar Çuçi – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: në shqyrtimin e projektligjit “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”. Komisioni ynë është për dhënie mendimi.

Të ftuar në komision kemi përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës.

Ju lutem, bëni një prezantim të shkurtër të projektligjit. Pastaj do të kalojmë në diskutime.

Renata Teta – Përshëndetje!

Projektligji vjen si një tekst i azhornuar i Kodit të vitit 2010, i ndryshimeve që ka pësuar në vitin 2011 dhe i ndryshimeve të mëvonshme. Për këto ndryshime e kemi filluar punën që në vitin 2015 dhe, duke parë se kishin ndryshuar shumë dispozita të tij, shumë emërtime, gjë që e bëri të vështirë ndryshimin e kodit ekzistues, menduam të paraqitej si një projektligj i ri, i cili nuk e ka ndryshuar strukturën e ligjit, por pason ndryshimet e mëparshme dh ndryshimet që do të pësojë gjatë kësaj periudhe.

Ky projektligj erdhi jo vetëm si rezultat i përafrimit të rregulloreve europiane dhe çdo kapitull i tij është një aneks në marrëveshjen ndërkombëtare të aviacionit civil.

Lidhur me pjesën e rregulloreve europiane, ne i kemi pasqyruar te faqja e parë e projektligjit 5 rregulloret europiane kryesore, por nuk është vetëm kaq pjesa e përafrimit, përafrimi i plotë i këtyre akteve do të bëhet edhe me aktet nënligjore që do të dalin, që janë 50 e ca akte, që janë VKM dhe udhëzime të ministrit për Infrastrukturën, si dhe nja dy udhëzime të përbashkëta me Ministrinë e Mbrojtjes për pjesën e menaxhimit të hapësirës ajrore.

Në fund të faqes ne kemi renditur rregulloret më kryesore dhe secila prej tyre prek nga një kapitull të veçantë dhe më kryesor të këtij projektligji. Është rregullorja nr. 108/2008 që lidhet me rregullat e operimit; rregullorja nr. 107/2009 që lidhet me performancën në aviacionin civil; është rregullorja nr. 996/2010 që lidhet me autoritetin e investigimit të aksidenteve dhe incidenteve dhe ky kapitull prek pak më shumë edhe se kapitujt e tjerë, sepse vetë rregullorja kishte pësuar ndryshime. Ky është quajtur autoritet. Më vonë ministria ka menduar që të jetë një autoritet i përbashkët edhe me organet e tjera të investigimit në transport, pra të jetë një autoritet që do të kishte në varësi tri autoritetet e investigimit, pra edhe transportin detar dhe atë rrugor.

Nisur nga këto rregullore, është bërë komplet një riformulim i përkufizimeve të këtij projektligji, duke shtuar përkufizime të reja, për arsye se ligji ekzistues shumë përkufizime i ka në dispozita. Komentet që paraqitëm lidhen më tepër me saktësime të formulimeve të përkthyer, të cilat në shumicën e rasteve janë përshtatje me legjislacionin tonë.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Me sa kuptoj, ka një mosrakordim midis sugjerimeve, që janë bërë nga shërbimet e Kuvendit në lidhje me përafrimin me pikat ku duhet të përafrohet më shumë projekti i ri me pjesën e legjislacionit europian. Sugjeroj ta rakordojmë një herë plotësisht me qeverinë dhe pastaj ta votojmë.

A jeni dakord ta shtyjmë projektligjin, pasi të rakordohemi më ministrinë përkatëse? Dakord.

A ka çështje të tjera për të diskutuar?

Faleminderit!

Për mbledhjen tjetër do t'ju njoftojmë nëpërmjet sekretarisë.

MBYLLET MBLEDHJA